



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION

Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, me 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për vitin 2024.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit nr.57/2019“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, udhëzimit nr.8 datë 8.5.2017, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 97 datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024.V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Është e drejta e Drejtorisë së Kujdesit Social, të përzgjedhë, një numër familjesh nga kategoritë më në nevojë dhe të trajtojë ato me një fond deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

Këto familje përzgjidhen nga aplikantët e listës së familjeve jo përfituese.

Për këto familje, duhet të kryhet detyrimisht kontrolli në familje dhe të shoqërohet me një vlerësim social-ekonomik nga një komision i përbërë prej tre administratorë shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social dhe Përgjegjës të Pagesave.

Lista e familjeve do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kritereve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive.

*Drejtoresë Përgjithshme e Drejtorisë Drejtor i Kujdesit Social
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Anxhela Qeramixhi(Dishnica)Mariana Jorgji

Kryetari i Bashkisë
Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KESHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

Përmiratimin e kriterevepërfamiljetnënevojëqë do tëtrajtohen me ndihmëekonomike, me 6% tëfondittëkushtëzuarpërblok-ndihmëekonomike,përVitin 2024.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, “Për vetë qeverisjen vendore”, Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 97 datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024, Ligji nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017 të Ministrisë të Mirëqënies Sociale,V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

VENDOSI:

KËSHILLI BASHKIAK

1-Miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për blok-ndihmën ekonomike ku:

Përfitues të fondit 6% do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndhmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimitpërpamjaftueshmëripikësh.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga një komision i ngritur nga Administratorët Shoqëror dhe Përgjegjës të Pagesave.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje Rome dhe Egjiptiane.
6. Vajza-Nëna në nevojë.

7. Familje të cilat kanë, probleme të ndryshme sociale.

**2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe
Drejtoria e Përgjithshme e Financës, buxhetit dhe MFK**

**3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6,
të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

K R Y E T A R

Eva NAÇI

Ana Verushi

Miratuar me _____vota

Vota Pro_____

Vota Kundër_____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2024

Përmiratimin e kritereve përfamiljet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, me 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmë ekonomike, për vitin 2024.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar . Ligjit nr. 97 datë 07.12.2023, "Për buxhetin e vitit 2024, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017 të Ministrisë të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1-Miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmë ekonomike.

Përfitues të fondit 6% do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndhmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit përpamjaftueshmëri pikësh.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga një komision i ngritur nga Administratorët Shoqëror dhe Përgjegjësit të Pagesave.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje Rome dhe Egjiptiane.
6. Vajza-Nëna në nevojë.
7. Familje të cilat kanë, probleme të ndryshme sociale (dhunë në familje, divorci, probleme shëndetësore, fatkeqësi natyrore, probleme me dokumentacionin në

përmbushje të kriterëve që përcakton ligji Nr.57 /2022 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”)

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës, buxhetit dhe MFK

3-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miratuar me _____vota

Vota Pro_____

Vota Kundër_____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____